



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:140246

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06456052

A.nr. 1737/22

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE, Departamenti për çështje administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, R.O. dhe J.O. nga komuna e G..., kundër të paditurës, Komuna e G..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson ... për shkak të “heshtjes së organit të paditur”, në seancën e shqyrtimit kryesor publik të mbajtur në prani të të autorizuarit të paditurit, e në mungesë të palëve së paditëse , me datë 23.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësve R.O. dhe J.O. nga komuna e G..., dhe detyrohet e paditura, komuna e ..., që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të merr aktvendim sipas ankesës së paditësve, të dorëzuar te e paditura me datë 10.03.2020 e protokolluar me numër 1398/20 dhe të njëjtin, t’ia dorëzoj paditësve, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palëve paditëse të ftuar dy herë përmes tabelës së shpalljes (provë: flet kthesat e datës 27.08.2024 dhe 22.10.2024), për arsye se në flet kthesat ku është ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore është konstatuar se “ *pala është i pa njohur* dhe në prani të autorizuarit të palës së paditur.

Paditësit në padinë e datës 08.07.2022 kanë kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar për shkak të heshtjes administrative, ashtu që të urdhërohet e paditura të nxjerr vendimin sipas ankesës të datës 10.03.2020 dhe sipas kërkesës së përsëritur në afatin prej 7 ditësh parashtresa e datës 07.07.2021 ,pasi që në rastin konkret ka heshtje administrative.

I autorizuari i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor ka kërkuar theksuar se, e paditura mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi nga përmbajtja e secilës del se padia është e pabazuar në tërësi, prandaj propozojmë që gjykata padinë e paditësve ta refuzoi si të pabazuar. Me tej thekson se, sa i përket kërkesës

së datës 10.03.2020 dhe kërkesës së datës 07.07.2021 nuk kemi vendosur mirëpo sa i përket përgjigjes në padi kemi dhënë përgjigje lidhur me këto kërkesa. Ne fund thekson se, pasi që paditësit janë ftuar në mënyrë të rregullt dhe nuk janë përgjigjur në thirrje propozo që gjykata të merr aktgjykim në bazë të mungesës dhe kërkesëpadi të refuzohet për shkak të mungesës së paditësve.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.10.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: kërkesa e dt.07.07.2021 me nr.prot.3228/21, kërkesa e dt.07.11.2018, shkresa e dt.22.06.2017, kopjet e letërnjoftimit për paditësit të dt.21.06.2018 dhe 07.02.2019, kërkesa e dt.10.03.2020 me nr.prot. 1398/20, shkresa e dt.26.11.18 me nr.prot.9334.

Gjykata vlerësoi pretendimet e paditëses për heshtje administrative duke vlerësuar gjendjen faktike, shkresat e lëndës, dhe duke vlerësuar thëniet dhe pretendimet e paditësit në padi, deklarimeve në përgjigjen në padi të paditurës, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 23.10.2024, konstaton se kërkesëpadi e paditësve për shkak të heshtjes administrative është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësit më ankesën e datës 10.03.2020 e protokolluar me numër 1398/20, i janë drejtuar të paditurës, Komuna e G... lidhur me shumën e pagesës në emër të tokës së konfiskuar, mirëpo e njëjta nuk ka vepruar në afatin e caktuar ligjor e as më pas. Po ashtu më datë 07.07.2021 me numer te protokollit 3228/21, paditësit kanë parashtruar kërkesë përsëritur për të vendosur lidhur me ankesën e datës 10.03.2020, me numër te protokollit 1398/20, por e paditura nuk ka marrë asnjë vendim edhe pas kërkesës së përsëritur të paditësve, të datës 07.07.2021, e as që e ka njoftuar të njëjtit lidhur me çështjen në procedurë.

Sipas nenit 76 dhe 77 të Ligjit për Procedurën Administrative organi administrativ, në këtë rast e paditura, ka pasur obligim që të marrë aktvendim lidhur me kërkesën-ankesën e paditësit, ndërsa e paditura në kundërshtim me ligjin, ka heshtur dhe nuk ka marrë vendim, e as nuk i është përgjigjur në asnjë formë paditësit.

Me nenin 29 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative është përcaktuar se “1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t’i është refuzuar ankesa. 2. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të te cilit nuk mund të bëhet ankesa. 3. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të te cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të

veçanta, pala ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim".

Meqenëse, e paditura nuk ka marrë vendim as pas kërkesës së përsëritur të paditësit të datës 07.07.2021, Gjykata vlerëson se paditësit me të drejtë ka iniciuar, kontestin gjyqësor kundër të paditurës, për shkak të heshtjes së administratës, meqenëse marrja e vendimit sipas ankesës së paraqitur dhe dorëzimi i saj, palës në procedurë, është obligim i organit të paditur.

Me nenin 131.2 të Ligjit për Procedurë Administrative, është paraparë se në qoftë se me kalimin e afatit të parashikuar për ankim, nuk është nxjerrë asnjë vendim mbi ankimin nga organi administrativ kompetent, palëve të interesuara, iu lindë e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës, në përputhje me ligjin.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative-juridike, ligji është zbatuar në dëm të paditësit, kështu që në ri procedurë, organi i paditur, do të ketë parasysh theksimet nga kërkesa-ankesa e paditësit, do të vërtetoj faktet relevante dhe pastaj, do të marr një vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura, janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Prandaj, bazuar në arsyet e dhëna më lart, në kuptim të nenit 5, 6, 26.2, 29, 38, si dhe nenit 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Gjykata aprovon padinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.1737/2022- data 23.10.2024

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.